



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORATI

Nr. 26/2 Prot.

Tiranë, më 04.10.2021

V E N D I M

Nr. 08, datë 01.10.2021

“Për disa shtesa në Udhëzuesin e Universitetit të Tiranës “Për zhvillimin e mësimin në distancë”

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 40 dhe në Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 36, në mbledhjen e datës 01.10.2021, Rektorati i Universitetit të Tiranës,

VENDOSI:

I. Në Udhëzuesin e Universitetit të Tiranës “Për zhvillimin e mësimin në distancë”, bëhen këto shtesa:

a) Pas paragrafit të fundit të pikës I “Zhvillimi i mësimin në distancë”, shtohet ky paragraf:

Në kushtet e mësimdhënies në distancë, regjistrimi i formave të ndryshme të vlerësimit (provime me pyetje-përgjigje me gojë, prezantimi i projekteve apo detyrave të ndryshme gjatë semestrit etj.), duke qenë mënyra e vetme e dokumentimit dhe garantimit të vlerësimit të drejtë dhe të paanshëm, do të kryhet duke synuar gjithmonë mbrojtjen e integritetit të të dy palëve në këtë proces, personel akademik dhe studentë.

b) Pas paragrafit III/2, të pikës III, shtohen këta paragrafë:

- i. *Për evidentimin e frekuentimit të leksioneve, studentët nuk kanë detyrim të paraqiten me pamje vizive në platformë.*
- ii. *Për evidentimin e frekuentimit të seminareve, punëve laboratorike, praktikave profesionale, detyrave dhe projekteve të kursit, studenti duhet të paraqitet me pamje “imazhe-video” (video call).*
- iii. *Për evidentimin e njohurive të përfuara, gjatë procesit të kontrollit të dijeve, studenti duhet të paraqitet me pamje “imazhe-video” (video call). Regjistrimi për efekt të vlerësimit të njohurive si dhe të ndjekjes së procedurave të ankimimeve të mundshme, sipas përcaktimeve në nenet 50 dhe 51 të Rregullores së UT-së, do të ruhet për 21 (njëzetë e një) ditë.*

- iv. *Për qëllimet e parashikuara në pikat "ii" dhe "iii", në orën e parë të zhvillimit të mësimit të çdo lënde, pedagogu i lëndës do të informojë studentët për detyrimin e plotësimit dhe dorëzimit të Formularit të Pëlqimit.*

Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Drejtoria e

Teknologjisë, Inovacionit dhe Statistika "**Për zhvillimin e mësimit në distancë**"

2. ve, pranë Rektoratit të UT-së.

3. Vendimi t'u përcillet të gjithë njësive përbërëse për zbatim.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Prof. Dr. Artan Hoxha

The image shows a circular official stamp of the University of Tirane. The text around the perimeter of the stamp reads "REPUBLIKA E SHqipëRIE" at the top and "UNIVERSITETI I TIRANË" at the bottom. In the center of the stamp, there is a smaller emblem. Overlaid on the stamp is a handwritten signature in black ink.